

PROCESVERBAL 22/2024

I mbajtur me rastin e takimit të 4 (katërt) të rregullt për vitin 2024 të Komunitetit për Komunitetet, mbajtur me datë 22.04.2024 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpallje “Qytetar Nderi” i Komunës së Suharekës;

3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343 të datës 28.01.2022;

4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve;

5.Të ndryshme;

Në mungesë të kryesuesit të komisionit z. Denis Sofra,takimin e hapi anëtari më i vjetër i këtij komisioni z.Nazim Shabanaj i cili i njoftoi me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Nazim Shabanaj - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpallje “Qytetar Nderi” i Komunës së Suharekës;

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor thotë që është një kërkesë nga Kryetari i komunës që Shkurte Fejza të shpallet “Qytetar Nderi” i Komunës së Suharekës për kontributin e saj,për çështjen e aktiviteteve të saj kulturore dhe muzikore.Nëse keni ndonjë vërejtje apo koment dikush,debati është i hapur.

Nazim Shabanaj - është këngëtare e mirë dhe është në rregull.E hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343 të datës 28.01.2022;

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor e elaboron pikën dhe thotë që bëhet fjalë për Këshillin Komunal për Siguri dhe Bashkësi ku dy anëtarët e këtij këshilli duhet të zëvendësohen sepse njëri prej përfaqësuesve islam ka dal në pension dhe në vend të tij ka ardhë Haki Hoxha dhe përfaqësuesja e policisë në KKSB ka qenë Fetije Bytyqi,e ndjera ka vdekur dhe ne e kemi obligim që ta zëvendësojmë dhe nga përfaqësuesit e policisë ka ardhë Qaush Hajdari.

Nazim Shabanaj - e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve;

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor elaboron pikën dhe thotë që vitin e kaluar Kryetari ka inicu një procedurë për të marrë një pëlqim për themelimin e ndërmarrjes publike “Eko Theranda”. Nga Kuvendi i komunës e kishte marrë autorizimin që të vazhdojë deri sa procedurat me ministrinë e linjes që ta merr themelimin e “Eko Therandës”. Ne vitin e kaluar e kemi marrë vendimin nga Kryeministri i cili na ka aprovu themelimin ndërmarrjes publike lokale dhe ne e kemi për obligim që ta themelojmë komisionin.

Nazim Shabanaj - pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën4.

Aprovohet pika 4.

Pika 5. Të ndryshme;

Nazim Shabanaj - prej shkollës deri te qendra Nura afër 13 shtylla nuk kanë ndriçim. Janë ndal para ramazanit dhe kërkoj që të rregullohen.

Avni Bytyqi - do ta adresoj si shqetësim sepse besoj që Komuna është duke e kontraktu një firmë për mirëmbajtjen e ndriçimit dhe besoj që hyn edhe fshati Gelancë.

Takimi përfundoi: 09:05